**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BANKA E SHQIPËRISË**
**Këshilli Mbikëqyrës**

**Vendim nr. 81, datë 15.11.2006**
**i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë**
**PËR**
**MIRATIMIN E RREGULLORES**
**"PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË"**

**Ndryshuar me**

**Vendimin nr. 78, datë 19.11.2008**
**të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë**
**PËR**
**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN**
**"PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË"**

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për prokurimin e mallrave, pasurive të paluajtshme, ndërtimeve dhe shërbimeve në Bankën e Shqipërisë.

### Neni 2
### Qëllimi dhe parimet

Qëllimi për të cilin hartohet kjo rregullore është përdorimi efektiv i fondeve të Bankës së Shqipërisë për të siguruar mallra dhe shërbime cilësore.

Parimet kryesore mbi bazën e të cilave hartohet kjo rregullore janë :

a) Parimi i barazisë, me synim trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në prokurim.

b) Parimi i sigurimit të pjesëmarrjes së kandidatëve në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë.

c) Parimi i nxitjes së konkurrencës në prokurim nëpërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, për ndërtime ose për shërbime dhe që plotësojnë nevojat dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë në sasi, cilësi e kohë.

ç) Parimi i sigurimit të përfitimeve maksimale për Bankën e Shqipërisë.

d) Parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe arritjes së transparencës në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë.

**Neni 3**
**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha prokurimet e mallrave, të shërbimeve ose të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë.
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Kryetarit të Entit Prokurues, mund të vendosë të ndryshojë procedurat e zakonshme të parashikuara në këtë rregullore ose të miratojë procedura të tjera, të veçanta për realizimin e prokurimeve.

**Neni 4**
**Përkufizime**

Sa herë që përdoren në këtë rregullore, termat e mëposhtëm nënkuptojnë :

- *"Prokurim"* nënkupton blerjen, marrjen me qira apo çdo mënyrë tjetër kontraktimi të mallrave, të shërbimeve ose të ndërtimeve për Bankën e Shqipërisë.
- *"Mallra"* nënkupton lëndët e para, produktet, makineritë dhe pajisjet, materialet në formë të ngurtë, të lëngshme e të gaztë dhe energjinë elektrike, si dhe shërbimet lidhur me furnizimin e këtyre mallrave si transporti, instalimi, mirëmbajtja dhe detyrimet e tjera të ngjashme, nëse vlera e tyre nuk e kalon atë të vetë mallrave.
- "*Pasuri të paluajtshme*" nënkupton të gjitha sendet e paluajtshme në kuptimin e nenit 2, paragrafi i dytë i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për miratimin e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të cilat i shërbejnë veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.
- *"Ndërtime"* nënkupton të gjitha sipërmarrjet dhe punimet që shoqërojnë ndërtimin, rindërtimin, shkatërrimin, riparimin ose rinovimin e një objekti ose struktura të tilla si, përgatitja e truallit, gërmimet, instalimi i pajisjeve dhe i materialeve, zbukurimet si dhe shërbimet që lidhen me to, nëse vlera e këtyre shërbimeve nuk e kalon atë të vetë ndërtimeve.
- *"Shërbime"* nënkupton çdo objekt prokurimi, përveç mallrave dhe ndërtimeve dhe pasurive të paluajtshme.
- *"Kandidat"* nënkupton një individ, person fizik tregtar ose person juridik, të ftuar për të marrë pjesë në prokurim ose që kërkon të ftohet.
- *"Ofertues"* nënkupton një individ, person fizik tregtar ose person juridik, që paraqet një ofertë ose kuotim pranë Bankës së Shqipërisë.

-*"Tender"* nënkupton një formë prokurimi, në të cilën ftohen subjekte, shqyrtohen, vlerësohen dhe seleksionohen të gjitha ofertat e marra zyrtarisht për të zgjedhur ofertën më të mirë për të lidhur kontratë.

-*"Tender i hapur"* nënkupton një procedurë prokurimi, në të cilën të gjithë kandidatët e interesuar mund të paraqesin ofertat e tyre pranë Bankës së Shqipërisë.

-*"Tender i kufizuar"* nënkupton një procedurë prokurimi, në të cilën vetëm kandidatët e ftuar nga Banka e Shqipërisë mund të paraqesin oferta.

-*"Prokurim i drejtpërdrejtë"* nënkupton një procedurë prokurimi, në të cilën Banka e Shqipërisë hyn në marrëdhënie dhe kërkon një propozim (ofertë) vetëm nga një kandidat.

-*"Ftesë për kuotim"* nënkupton një procedurë prokurimi, nëpërmjet të cilës Banka e Shqipërisë kërkon kuotime nga kandidatët e zgjedhur prej saj.

-*"Dokumentet e tenderit, të ftesës për kuotim ose të prokurimit të drejtpërdrejtë"* nënkupton dokumentet që Banka e Shqipërisë vë në dispozicion të kandidatëve, si bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

-*"Fond limit"* nënkupton vlerën monetare, që përcaktohet nga Kryetari i Entit Prokurues, për realizimin e objektit të prokurimit, referuar buxhetit të Bankës së Shqipërisë dhe studimit të tregut, të realizuar nga Sektori i Prokurimit.

-*"Kontratë"* nënkupton çdo lloj marrëveshjeje, të lidhur (nënshkruar) midis ofertuesit fitues dhe Bankës së Shqipërisë.

- "*Kontraktues*" nënkupton një individ, person fizik tregtar ose person juridik, që ka lidhur një kontratë për mallra, për shërbime ose për ndërtime.

-"*Pezullim*" nënkupton ndërprerje të procedurës së prokurimit në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

-"*Anulim*" do të thotë ndërprerje dhe përsëritje nga fillimi e një procedure prokurimi, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

-" *Rivlerësim*" do të thotë rishikim dhe korrigjim i të metave të vëna re nga Guvernatori ose Kryetari i Entit Prokurues në një procedurë prokurimi, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

-"*Komisioni i Prokurimit*" nënkupton komisionin që ngrihet me urdhrin e prokurimit dhe që ngarkohet për marrjen, për shqyrtimin dhe për vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit në zbatim të kësaj rregulloreje.

- "*Grupi i Shqyrtimit Paraprak*" nënkupton grupin që ngrihet me miratimin e Kryetarit të Entit Prokurues dhe që realizon përzgjedhjen e pasurisë së paluajtshme që plotëson më mirë kërkesat tekniko-ekonomike të Bankës së Shqipërisë.

-" *Ent Prokurues*" nënkupton Bankën e Shqipërisë.

-"*Kryetar i Entit Prokurues*" nënkupton Zëvendësguvernatorin e Dytë të Bankës së Shqipërisë.

**Neni 5**
**Disponueshmëria e rregullores për publikun**

Kjo rregullore dhe çdo ndryshim i mundshëm i saj vihen në dispozicion të publikut dhe kjo disponueshmëri respektohet sistematikisht.

## KREU II
## ZGJEDHJA E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

### Neni 6
### Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë janë:
-tender i hapur (kombëtar ose ndërkombëtar);
-tender i kufizuar (kombëtar ose ndërkombëtar);
-ftesë për kuotim (kombëtare ose ndërkombëtare);
-prokurim i drejtpërdrejtë;
-procedurë e kombinuar (kombëtare ose ndërkombëtare).

Prokurimet në Bankën e Shqipërisë planifikohen në mënyrë racionale dhe asnjë kërkesë për prokurimin e një sasie të dhënë të mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve nuk duhet të ndahet me qëllim që të shmanget një procedurë e prokurimit e përcaktuar në rregullore.
”Tenderi i hapur”, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë kre, përdoret si procedurë e preferuar prokurimi.

Enti Prokues mund të përdorë procedurë tjetër prokurimi përvec tenderit të hapur, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 3 paragrafi i dytë, nenet 8, 9 dhe10.

### Neni 7
### Kufijtë monetarë për përdorimin e “Tenderit të hapur”

Prokurohet nëpërmjet “Tenderit të hapur” kur vlefta e fondit limit është mbi kufirin monetar të përcaktuar si më poshtë:

*Për ndërtimet* – 15.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja).

*Për mallrat* - 9.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja).

*Për shërbimet* - 3.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja), me përjashtim të projektimeve, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.

*Në qoftë se kursi mesatar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë do të ndryshojë tej kufirit +/- 10 për qind, kufiri monetar do të ndryshojë në raport të kursit të këmbimit.*

### Neni 8
### Kushtet dhe kufijtë monetarë për përdorimin e “Tenderit të kufizuar”

Prokurohet nëpërmjet “Tenderit të kufizuar” kur:

a-mallrat, ndërtimet ose shërbimet janë të disponueshme vetëm nga një numër i kufizuar kandidatësh;

b- vlefta e fondit limit është brenda kufirit monetar të përcaktuar si më poshtë:

*Për ndërtimet* –15.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja).

*Për mallrat* - 9.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja).

*Për shërbimet - 3.000.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja), me përjashtim të kontratave afatgjata të shërbimit, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për realizimin e shërbimit në një vit kalendarik.*

*Në qoftë se kursi mesatar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë do të ndryshojë tej kufirit +/- 10 për qind, kufiri monetar do të ndryshojë në raport të kursit të këmbimit.*

c) Tenderi i hapur për motive të tjera (për shembull konfidencialiteti, besueshmërie etj.) është jo i përshtatshëm. Në këtë rast, do të merret paraprakisht miratimi me shkrim nga Guvernatori.

**Neni 9**
**Kushtet dhe kufijtë monetarë për përdorimin e "Ftesës për kuotim"**

Prokurohet nëpërmjet "Ftesës për kuotim" kur :

a-ndërtimet, shërbimet apo mallrat që do të prokurohen për nevoja të Bankës së Shqipërisë kanë një treg të stabilizuar;

b-vlefta e fondit limit është brenda kufirit monetar prej:

- 5.000.000 lekësh (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) për ndërtimet.
- 3.000.000 lekësh (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) për mallrat.
- 1.000.000 lekësh (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) për shërbimet me përjashtim të kontratave afatgjata të shërbimit, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për realizimin e shërbimit në një vit kalendarik.

*Në qoftë se kursi mesatar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë do të ndryshojë tej kufirit +/- 10 për qind, kufiri monetar do të ndryshojë në raport të kursit të këmbimit.*

**Neni 10**
**Kushtet për përdorimin e "Prokurimit të drejtpërdrejtë"**

Prokurohet nëpërmjet "Prokurimit të drejtpërdrejtë":

a- kur në mungesë të konkurrencës për arsye teknike mallrat, ndërtimet ose shërbimet sigurohen vetëm nga një kandidat ose kur një kontraktues ka të drejtën ekskluzive për mallrat, për ndërtimet ose për shërbimet;

b- për lëvrime të mallrave dhe/ose shërbimeve nga kontraktuesi i mëparshëm, të cilat bëhen ose si zëvendësim ose si shtim i mallrave dhe/ose shërbimeve ekzistuese dhe kur një ndryshim i kontraktuesit do të detyronte Bankën e Shqipërisë të prokuronte mallra dhe/ose shërbime, të cilat nuk do të plotësonin kërkesat e përshtatshmërisë me mallrat ose me shërbimet ekzistuese. Kjo për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e çmimit të kontratës fillestare dhe kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në 3 muaj pas përfundimit të saj;

c- kur shërbimet suplementare të ndërtimit, të cilat nuk janë në kontratën fillestare, për shkak të rrethanave të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme dhe ndarja e shërbimeve suplementare të ndërtimit nga kontrata fillestare do të ishte e vështirë për arsye teknike ose ekonomike. Kjo për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e çmimit të kontratës fillestare, kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në 3 muaj pas përfundimit të saj;

ç- për shërbime të reja ndërtimi, që konsistojnë në përsëritjen e shërbimeve të ngjashme të ndërtimit, të cilat janë  sipas projektit bazë, me kusht që për këtë projekt kontrata fillestare të jetë lidhur mbi bazën e tenderit të hapur ose të kufizuar. Kjo për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e çmimit të kontratës fillestare dhe kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në 3 muaj pas përfundimit të saj;

d- për vazhdimin e shërbimeve të konsulencës për të cilat kontrata origjinale është zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe vazhdimi i këtyre shërbimeve mund të sjellë avantazhe ekonomike dhe efektivitet;

dh- për blerje ose shërbime, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me cilësitë personale të kandidatit individ (si për shembull, për studime, piktura, skulptura, programime, metodika, konsulencë, përkthime, avokati etj.);

e- për vazhdimin e shërbimeve të projektimit që janë të lidhura me shërbime të tjera të kryera më parë, të cilat, po t'i jepen një subjekti të ri, do të cënonin të drejtën e autorit;

ë- për rastet e blerjes të mallrave ose shërbimeve në kushte jashtëzakonisht të favorshme, që shfaqen vetëm në një kohë të shkurtër. Kjo dispozitë zbatohet në rastet e shitjeve jo të zakonshme nga persona juridikë ose fizikë, të cilët normalisht nuk janë furnizues. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim për prokurimet e zakonshme nga furnizues të rregullt;

f-për nevojë urgjente për mallra, për ndërtime ose për shërbime, e cila është shkaktuar nga rrethanat jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë dhe koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera të prokurimit, të parashikuara në këtë rregullore;

g- për mallra dhe/ose për shërbime, të cilat për arsye teknike apo për arsye konfidencialiteti duhet të blihen apo të kryhen nga kontraktuesi i mëparshëm;

gj- kur pas anulimit dhe përsëritjes së procedurës së prokurimit, në përputhje me nenin 41, paragrafi 3,  përsëri rezulton vetëm një kandidat ose një ofertë, ose një kuotim;

h- kur gjykohet të prokurohen mallra dhe shërbime për të cilat, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 20.12.2002 “Për përdorimin e fondeve

buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", janë kryer procedurat e prokurimit dhe është shpallur oferta fituese nga ana e institucioneve përkatëse prokuruese.
Në këto raste, kontrata do të nënshkruhet me kushtin që çmimi për njësi të mos jetë më i madh se ai për të cilin është shpallur oferta fituese nga institucioni prokurues;

i- për blerje të mallrave dhe/ose shërbimeve të ofruara nga prodhues ekskluzivë, të cilat kërkohen të blihen direkt nga prodhuesi për arsye të përfitimit të efektivitetit teknik dhe avantazheve ekonomike;

j- kur një procedurë e tillë, përjashtimisht nga rastet e mësipërme, miratohet me shkrim nga Guvernatori;

k- për vazhdimin e shërbimeve të të tretëve ndaj Bankës së Shqipërisë për të cilët kontrata e mëparshme është zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe përsa kohë vazhdimi i ofrimit të këtyre shërbimeve nga i njëjti kontraktor garanton sigurinë e jetës së punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe/ose të vetë insitucionit. Vendimi i Kryetarit të Entit Prokurues për përdorimin e procedurës të "*prokurimit të drejtpërdrejtë*" sipas kësaj shkronje, bazohet në çdo rast në raportin me shkrim të punonjësit të autorizuar për ndjekjen e kontratës dhe të Departamentit të Administrimit nëse kontrata e mëparshme është zbatuar në mënyrë të kënaqshme, si dhe në vlerësimin me shkrim të departamentit të interesuar mbi garancinë për sigurinë e jetës së punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe/ose të vetë institucionit.

l- përveç rasteve të mësipërme kjo procedurë përdoret për blerjen e pasurive të paluajtshme, kur vërtetohen kushtet e nenit 61 të kësaj rregulloreje.

## KREU III
## TENDERI I HAPUR KOMBËTAR

### Neni 11
### Dispozita bazë për tenderin e hapur kombëtar

Tenderi i hapur kombëtar përdoret kur mallrat, shërbimet ose ndërtimet që do të prokurohen janë të sigurueshme nga burimet vendase dhe ka konkurrencë të mjaftueshme brenda vendit. Në procedurën e tenderit të hapur kombëtar do të zbatohen dispozitat e mëposhtme.

### Neni 12
### Njoftimi për tender

Njoftimi për tender duhet të përmbajë të paktën:

- Fondin limit të vënë në dispozicion.
- Objektin e prokurimit (me sasitë përkatëse kur prokurohen mallra).
- Procedurën e prokurimit.
- Vendin dhe çmimin e tërheqjes së dokumenteve të tenderit.
- Vendin, datën dhe orën e hapjes së tenderit.

**Neni 13**
**Shpallja e njoftimit për tender**

Shpallja e njoftimit për tenderin e hapur bëhet nëpërmjet publikimit të tij në të paktën dy gazeta vendase me tirazhin më të madh dhe në tre numra të njëpasnjëshëm të tyre, në Buletin Zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe në website-in e Bankës së Shqipërisë.
Afati nga data e fundit e shpalljes së njoftimit në gazetë deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 20 ditë kalendarike.

**Neni 14**
**Dokumentet e tenderit**

Dokumentet e tenderit duhet të përmbajnë gjithë informacionin e nevojshëm për të përgatitur ofertën si dhe të përmbajnë informacion të mjaftueshëm, në mënyrë që konkurrenca ndërmjet ofertuesve në tender të bëhet mbi bazën e kushteve të plota, të paanshme dhe objektive. Në raste të veçanta, në varësi të kompleksitetit të objektit që prokurohet, dokumentet e tenderit mund të përgatiten nga ndonjë subjekt apo ent i specializuar, vendas apo i huaj. Dokumentet e tenderit duhet të përmbajnë të paktën:

(a) të dhëna përshkruese të objektit që do të prokurohet në të cilat të përfshihen, kur është e mundshme, kërkesat sasiore;

(b) udhëzime për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertave dhe të dokumentacionit shoqërues;

(c) afatin e fundit të pranimit të ofertave, adresën ku duhen dërguar ato, datën, orën, vendin ku do të bëhet hapja e tyre, si dhe njoftimin që ofertuesit ose përfaqësuesit e autorizuar prej tyre janë të lejuar të ndjekin hapjen e ofertave;

(ç) specifikimet teknike dhe/ose specifikimet e plota të kërkesave për mallrat, për ndërtimet ose për shërbimet që do të prokurohen;

(d) dokumentet që duhet të paraqiten nga kandidati për të demonstruar kualifikimet e tij, në përputhje me nenin 35 të kësaj rregulloreje;

(dh) periudhën minimale gjatë të cilës oferta duhet të jetë e vlefshme;

(e) kriteret për vlerësimin e ofertave dhe të shpalljes së ofertës fituese;

(ë) formularin e ofertës, i cili duhet të përmbajë konfirmimin e kandidatit për vlerën monetare me të cilën ai merr përsipër realizimin e objektit të prokurimit, si dhe deklarimin e tij se oferta e tij është në përputhje me kushtet e kontratës dhe me specifikimet teknike të dhëna në dokumentet e tenderit;

(f) kontratën-tip ose kushtet e përgjithshme dhe specifike të kontratës sipas objektit të prokurimit;

(g) kushtin e sigurimit të ofertës;

(gj) një klauzolë ku shprehet se Banka e Shqipërisë mund t'i refuzojë të gjitha ofertat në çfarëdo kohe përpara shpalljes së ofertës fituese;

(h) referimin që i bëhet rregullores “Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”, si baza rregullatore mbi të cilën mbështeten prokurimet në Bankën e Shqipërisë, në mbështetje të së cilës janë hartuar dokumentet e tenderit.

**Neni 15**
**Disponueshmëria e dokumenteve të tenderit**

Dokumentet e tenderit do t'u vihen në dispozicion kandidatëve brenda një kohe sa më të shkurtër, me një çmim që synon të mos e kalojë koston e riprodhimit dhe të dorëzimit të tyre deri te kandidatët, në mënyrën e specifikuar në njoftimin për tender.

**Neni 16**
**Sqarimi dhe/ose modifikimi i dokumenteve të tenderit**

Komisioni i Prokurimit, në çfarëdo kohe përpara mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e tij ose në përgjigje të një kërkese nga një kandidat që ka blerë dokumentet e tenderit, mund t'i modifikojë ato dhe njofton kandidatët për këtë modifikim.
Kërkesat për modifikimin/sqarimin e dokumenteve të tenderit pranohen deri në 5 (pesë) ditë para mbarimit të afatit të paraqitjes së ofertave.
Si rregull, komisioni vendos për dhënien e sqarimeve ose për modifikimin e dokumenteve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës.
Komisioni i Prokurimit do t’i përgjigjet me shkrim çdo kërkese për sqarime që mund të marrë brenda afateve të caktuara kohore. Kopje të përgjigjes u dërgohen menjëherë të gjithë kandidatëve që kanë blerë dokumentet e tenderit.
Kur komisioni vendos të modifikojë dokumentet e tenderit afati i fundit i pranimit të ofertave do të jetë jo më pak se 5 ditë nga njoftimi i kandidatëve për këtë modifikim. Ky afat nuk do të tejkalojë afatin minimal të njoftimit të përcaktuar për procedurën përkatëse të tenderimit.

**Neni 17**
**Paraqitja dhe pranimi i ofertave**

Ofertat duhet të paraqiten me shkrim, të nënshkruara, të vulosura dhe të mbyllura në një zarf, në vendin, datën dhe orën e caktuar për paraqitjen e ofertave, sipas mënyrës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.
Ofertat e mbërritura pas fillimit të procedurës së prokurimit, duhet t'i kthehen të pahapura kandidatëve që i kanë paraqitur ato.

**Neni 18**
**Hapja dhe shqyrtimi i ofertave**

Ofertuesit ose përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, duhet të lejohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
Ofertat hapen nga Komisioni i Prokurimit (i cili i firmos ato në çdo fletë) në datën, në orën dhe në vendin e caktuar në dokumentet e tenderit dhe shqyrtohen si më poshtë:

## MËNYRA E PARË

*a) Faza e parë,* gjatë së cilës në prani të kandidatëve bëhet hapja dhe shqyrtimi i dokumentacionit vërtetues për plotësimin e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në përputhje me nenin 35 të kësaj rregulloreje. Vetëm ofertuesit që kanë përmbushur kriteret e kërkuara për kualifikim, do të kalojnë në fazën e dytë.
b*) Faza e dytë* gjatë së cilës do të bëhet hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës tekniko-ekonomike.
Hapja e ofertës tekniko-ekonomike nuk bëhet pa përfunduar kualifikimi i ofertuesve. Ofertuesit, të cilët kanë plotësuar kërkesat për kualifikim, konsiderohen të kualifikuar. Komisioni mbasi ka deklaruar ofertuesit e skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, hap ofertat tekniko-ekonomike të ofertuesve të kualifikuar dhe lexon me zë të lartë çmimet dhe kërkesat e tjera të mundshme, në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit harton procesverbalin përkatës një kopje e të cilit u jepet dhe kandidatëve. Të gjitha fletët e secilës ofertë tekniko-ekonomike firmosen nga të gjithë anëtarët e komisionit.
Komisioni i Prokurimit mund t'u kërkojë ofertuesve të japin sqarime për ofertat e paraqitura, me qëllim që ta ndihmojnë atë në shqyrtimin dhe në vlerësimin teknik të tyre.

## MËNYRA E DYTË[I]

*a) Faza e parë* gjatë së cilës bëhet hapja dhe shqyrtimi i dokumentacionit vërtetues për plotësimin e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 35 të kësaj rregulloreje, duke u hartuar për këtë qëllim procesverbali përkatës.
Vetëm ofertuesit që kanë përmbushur kriteret e kërkuara për kualifikim, do të kalojnë në fazën e dytë.

b*) Faza e dytë* gjatë së cilës bëhet hapja dhe shqyrtimi i ofertës teknike (pa çmime), për shkallën e përmbushjes së kërkesave dhe/ose të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga secili prej ofertuesve. Komisioni i Prokurimit mund t'u kërkojë ofertuesve të japin sqarime ose shpjegime për ofertat teknike të paraqitura, me qëllim që ta ndihmojnë atë në shqyrtimin dhe në vlerësimin teknik të tyre.

---
[I] Përdoret, si rregull, për prokurimin e ndërtimeve apo të projektimeve të mëdha e komplekse.

Komisioni i Prokurimit vlerëson ofertat teknike dhe i klasifikon ato në përputhje me kriteret e vlerësimit të parashikuara në dokumentet e tenderit, duke hartuar procesverbalin përkatës.
Në rast të përfshirjes së çmimit të ofertës gjatë kësaj faze, ofertuesi përjashtohet nga konkurimi i mëtejshëm.

c*) Faza e tretë* gjatë së cilës do të bëhet hapja e ofertës ekonomike, leximi i çmimeve dhe i kërkesave të tjera të mundshme në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Pas këtij momenti (dhe mbajtjes së procesverbalit përkatës) ofertuesit do të largohen dhe Komisioni i Prokurimit do të shqyrtojë e vlerësojë ofertat e dhëna.

## KREU IV
## PROCEDURA TË TJERA PROKURIMI (KOMBËTARE)

### Neni 19
### Tenderi i kufizuar kombëtar

Procedura e "Tenderit të kufizuar kombëtar" është e njëjtë me atë që zbatohet në tenderin e hapur kombëtar, me përjashtim që:

(a) ftesa për tender i adresohet një numri jo më të vogël se 5 kandidatësh të kualifikuar profesionalisht;
(b) afati nga data e njoftimit të kandidatit deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 15 ditë kalendarike.

### Neni 20
### Ftesa për kuotim kombëtare

Dokumentet për këtë lloj procedure duhet të përmbajnë: fondin limit të vënë në dispozicion për prokurim, një përshkrim të qartë për kërkesat e objektit të prokurimit lidhur me cilësinë, me sasinë, me kushtet ose me kohën e kërkuar për dorëzim, periudhën minimale gjatë së cilës kuotimi duhet të jetë i vlefshëm dhe/ose kërkesa të tjera të veçanta të përfshira në dokumentet e ftesës për kuotim.
Numri i kandidatëve që do të ftohen në procedurën "Ftesë për kuotim" është jo më pak se 4. Në qoftë se ky numër nuk mund të plotësohet atëherë aplikohet paralelisht edhe njoftimi në gazetë.
Kandidatëve, persona fizikë tregtarë ose atyre juridikë, së bashku me kuotimin, si dokumentacion për kualifikim, do t'u kërkohet vërtetimi për regjistrimin si person fizik tregtar ose juridik , dhe sipas rastit konkret, leja e ushtrimit të veprimtarisë e lëshuar nga organi kompetent. Sipas objektit konkret të prokurimit, komisioni mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë.

Kandidatëve individë, dokumentacioni për kualifikim do t'u kërkohet në përputhje me cilësitë, me kualifikimet profesionale e kërkesat që ata duhet të plotësojnë për realizimin e objektit të prokurimit.
Dorëzimi, hapja e shqyrtimi i kuotimeve dhe i dokumentacionit për kualifikim do të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara nga komisioni në dokumentet e ftesës për kuotim.
Afati nga data e njoftimit të kandidatit deri në datën e pranimit të kuotimit është jo më pak se 5 ditë kalendarike.

**Neni 21**
**Prokurimi i drejtpërdrejtë**

Në prokurimin e drejtpërdrejtë, Komisioni i Prokurimit hyn në marrëdhënie dhe kërkon propozim nga kandidati i përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit, si dhe negocion për kushtet e kontratës.

Dokumentet për këtë lloj procedure duhet të përmbajnë një përshkrim të qartë për objektin e prokurimit, për cilësinë, për sasinë, për kushtet ose për kohën e kërkuar për dorëzim dhe/ose kërkesa të tjera në përputhje me objektin konkret të prokurimit.

## KREU V
## PROCEDURA NDËRKOMBËTARE PROKURIMI

**Neni 22**
**Dispozita të përbashkëta të procedurave ndërkombëtare**

Banka e Shqipërisë përdor procedurat ndërkombëtare të prokurimit, kurdoherë që:
a) në procedurat kombëtare të prokurimit konkurrenca e efektshme për një kontratë për prokurimin e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen edhe të kandidatëve të huaj;
b) objekti i prokurimit nuk mund të realizohet nga kandidatë vendas.

Në procedurat ndërkombëtare marrin pjesë kandidatë të huaj dhe kandidatë vendas.
Dokumentacioni për kandidatët e huaj do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentacioni për kandidatët vendas, nëse ka të tillë, do të jetë gjithmonë në gjuhën shqipe.
Specifikimet teknike, mundësisht sa më të përshtatshme me kërkesat kombëtare, duhet të mbështeten në standardet ndërkombëtare ose në standardet që përdoren gjerësisht në tregun ndërkombëtar.
Kandidatët do të lejohen të paraqesin ofertat e tyre, si dhe çdo dokument sigurimi që ata mund të paraqesin, në monedhat e tyre kombëtare ose në një monedhë që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, në përputhje me dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim.

Kushtet e përgjithshme dhe specifike të kontratës do të jenë të tilla që përdoren gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare.

**Neni 23**
**Tenderi i hapur ndërkombëtar**

Procedura e tenderit të hapur ndërkombëtar do të respektojë dispozitat e Kreut III të kësaj rregulloreje dhe dispozitat e mëposhtme.
Për kandidatët e huaj, njoftimi për këtë lloj tenderi duhet të bëhet në një gazetë që botohet në gjuhën angleze dhe që ka tirazh të mjaftueshëm për të tërhequr konkurrencën ndërkombëtare si dhe në website-in e Bankës së Shqipërisë.
Afati nga data e fundit e shpalljes së njoftimit në gazetë deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 45 ditë kalendarike.

**Neni 24**
**Tenderi i kufizuar ndërkombëtar**

Procedura e tenderit të kufizuar ndërkombëtar është e njëjtë me procedurën e tenderit të kufizuar kombëtar me përjashtim që:
Njoftimi për tender u adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj, të kualifikuar.
Afati nga data e njoftimit të kandidatit deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 35 ditë kalendarike.

**Neni 25**
**Ftesa për kuotim ndërkombëtare**

Procedura e "Ftesës për kuotim ndërkombëtar" është e njëjtë me atë që zbatohet në "Ftesën për kuotim kombëtar", me përjashtim që:
a) ftesa i adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj të kualifikuar;
b) kandidatëve të huaj u kërkohet si dokumentacion për kualifikim vetëm dokumenti që vërteton zotësinë juridike për të vepruar të kandidatit;
c) kur kandidatët janë vetëm të huaj, kuotimi dhe dokumentacioni për kualifikim mund të pranohen me faks.

## KREU VI
## PROCEDURAT E KOMBINUARA (KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE) TË PROKURIMIT

**Neni 26**
**Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj**

Kur Banka e Shqipërisë e gjykon si të dobishme dhe të përshtatshme, mund të përdoret një formë e kombinuar "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj".
Kjo procedurë është e njëjtë me atë që zbatohet në tenderin e hapur ndërkombëtar, me përjashtim që:

a) ftesa i adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj të kualifikuar;
b) kandidatëve të huaj, dokumentet e tenderit u adresohen direkt dhe jo nëpërmjet njoftimit në gazetë;
c) afati nga data e njoftimit të kandidatit të huaj deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 30 ditë kalendarike.

### Neni 27
### Tender i kufizuar kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj

Kur Banka e Shqipërisë e gjykon si të dobishme dhe të përshtatshme mund të përdoret një formë e kombinuar "Tender i kufizuar kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj".
Kjo procedurë është e njëjtë me atë që zbatohet në tenderin e kufizuar ndërkombëtar, me përjashtim që:

a) ftesa i adresohet një numri jo më të vogël se 3 kandidatësh të huaj të kualifikuar;
b) kandidatëve të huaj, dokumentet e tenderit u adresohen direkt dhe jo nëpërmjet njoftimit në gazetë;
c) afati nga data e njoftimit të kandidatit të huaj deri në datën e pranimit të ofertave është jo më pak se 20 ditë kalendarike.

## KREU VII
## DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA PROCEDURAT E PROKURIMIT

### Neni 28
### Forma e komunikimit

Komunikimi ndërmjet kandidatëve dhe Komisionit të Prokurimit, si rregull, bëhet me shkrim. Në qoftë se komunikimi bëhet në një formë tjetër, ai duhet t'i referohet vetëm dokumentacionit me shkrim dhe përmbajtja e tij duhet të paraqitet me shkrim menjëherë pas këtij komunikimi.

### Neni 29
### Sigurimi i ofertës

Banka e Shqipërisë duhet të përfshijë në dokumentet e tenderit kushtin e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare ose të garancisë së lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve apo të subjekteve jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Vlera e këtij sigurimi duhet të jetë 2 për qind deri në 3 për qind e fondit limit dhe e dhënë në

vlerë absolute. Kushti i sigurimit të ofertës është i detyrueshëm për tenderin e hapur dhe të kufizuar (kombëtar ose ndërkombëtar ose të kombinuar). Komisioni në varësi të objektit konkret të prokurimit, mund ta parashikojë këtë kusht edhe për procedura të tjera prokurimi.

Sigurimi i ofertës duhet të konfiskohet nga Banka e Shqipërisë, në rast se: a) një ofertues tërheq ofertën e tij brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës; b) një ofertues fitues, heq dorë nga lidhja e kontratës ose nuk është në gjendje të japë sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të kontratës, në qoftë se do të kërkohet një sigurim i tillë.

Sigurimi i ofertës për kandidatët që skualifikohen për mosplotësimin e kërkesave për kualifikim, çlirohet brenda 5 ditëve pune nga skualifikimi. Për kandidatët e tjerë të kualifikuar për në fazën e shqyrtimit të ofertës tekniko-ekonomike, sigurimi i ofertës çlirohet brenda 5 ditëve pune pas lidhjes së kontratës me ofertuesin fitues ose me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së ofertës.

## Neni 30
## Sigurimi i kontratës

Ofertuesi fitues në tender për lidhjen (nënshkrimin) e kontratës me Bankën e Shqipërisë si dhe për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të tij kontraktore, detyrohet të plotësojë kushtin e sigurimit të kontratës në formën e garancisë bankare (të lëshuar vetëm nga banka). Kushti i sigurimit të kontratës do të jetë 10 deri 20 për qind e çmimit në total të kontratës.

Kushti i sigurimit të kontratës është i detyrueshëm për tenderin e hapur dhe të kufizuar (kombëtar ose ndërkombëtar ose të kombinuar). Komisioni, në varësi të objektit konkret të prokurimit mund ta parashikojë këtë kusht edhe për procedura të tjera prokurimi.

## Neni 31
## Monedha e ofertave (kuotimeve)

Në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim duhet të përcaktohet: a) monedha ose monedhat me të cilat pjesëmarrësit do të shpallin çmimet e tyre; b) procedurat e konvertimit të çmimeve të shprehura në monedha të ndryshme (jo më shumë se tre) në një monedhë të vetme, për efekt të krahasimit të ofertave; c) monedhat në të cilat do të kryhet pagesa për vleftën (çmimin) e kontratës. Kursi i këmbimit të monedhave duhet të jetë kursi i shitjes i 28 ditëve përpara datës së hapjes së tenderit. Në këtë mënyrë, eliminohet rreziku i keqkuptimit në këmbimin valutor, sigurohet ndershmëri dhe transparencë gjatë procesit të vlerësimit dhe u jepet mundësia pjesëmarrësve në tender nga vendet me monedhë më të dobët për të përdorur një monedhë më të fortë.

## Neni 32
## Refuzimi i të gjitha ofertave apo kuotimeve

Banka e Shqipërisë mund t'i refuzojë të gjitha ofertat apo kuotimet në çfarëdo kohe para shpalljes së ofertuesit fitues, në rast se një gjë e tillë është specifikuar në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim dhe me kusht që refuzimi i tyre të justifikohet me arsye të forta ekonomike. Banka e Shqipërisë duhet t'i komunikojë çdo kandidati ose ofertuesi këtë refuzim pa qenë e detyruar ta justifikojë atë.
Banka e Shqipërisë, në bazë të paragrafit të mësipërm, nuk do të ketë asnjë përgjegjësi para kandidatëve ose ofertuesve.
Në qoftë se vendimi për refuzimin e të gjitha ofertave apo kuotimeve merret para afatit të fundit të paraqitjes së tyre, ato duhet t'u kthehen të pahapura kandidatëve që i kanë paraqitur.

## Neni 33
## Stimujt nga kandidatët

Komisioni i Prokurimit dhe çdo nëpunës i Bankës së Shqipërisë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit duhet të refuzojnë çdo ofertë ose kuotim, në rast se kandidati ose ofertuesi jep ose premton të japë, stimuj monetarë ose jomonetarë për efekt të një akti, vendimi ose procedure që do të ndërmerret në Bankën e Shqipërisë lidhur me procedurat e prokurimit. Refuzimi dhe arsyet e një vendimi të tillë duhet të shkruhen në procesverbalet e prokurimit dhe duhet t'i njoftohen zyrtarisht menjëherë kandidatit ose ofertuesit.

## Neni 34
## Procedura në rastet e ardhjes me vonesë të ofertave ose të kuotimeve

Ofertat apo kuotimet që merren pas afatit të fundit të dorëzimit të tyre, nuk do të pranohen dhe do t'u kthehen të pahapura kandidatëve ose përfaqësuesve të tyre, të autorizuar me shkrim.
Në rastin e kuotimeve me faks, i komunikohet ofertuesit mospranimi i ofertës për shkak të ardhjes me vonesë të saj.

## Neni 35
## Kërkesat për kualifikimin e kandidatëve

Sipas llojit të procedurës së prokurimit dhe objektit konkret të prokurimit, kandidatët duhet të kualifikohen duke plotësuar kërkesat e mëposhtme, që Komisioni i Prokurimit i konsideron të nevojshme sipas rrethanave:

- të kenë zotësi juridike për të vepruar;

- të kenë kryer më parë kontrata të ngjashme e të përafërta me ato të përcaktuara në objektin e prokurimit;
- të mos jenë në ndjekje penale;
- të mos jenë në proces gjyqësor për çështje që lidhen me aktivitetin e tyre;
- të kenë përmbushur detyrimet e tyre për shlyerjen e detyrimeve fiskale;
- të kenë përmbushur detyrimet e tyre për shlyerjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore;
- të kenë aftësinë e duhur profesionale, teknike dhe organizative, personel, burime financiare, makineri e pajisje të tjera, reputacion dhe besueshmëri për zbatimin e kontratës.

Komisioni për çdo rast konkret prokurimi, mund t'u kërkojë kandidatëve të paraqesin informacione ose dokumente të tjera që i konsideron si të nevojshme.

Do të skualifikohet çdo kandidat, në qoftë se konstatohet në çdo kohë, deri në nënshkrimin e kontratës, që informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose të dhënat që kanë lidhje me vlerësimin e tij ose të ofertës së tij, janë të rreme, të pasakta ose jo të plota.

## Neni 36
## Kërkesat dhe specifikimet teknike

Kërkesat dhe specifikimet teknike, përshkrimi i mallrave, i ndërtimeve dhe i shërbimeve që do të prokurohen duhet të jenë përpiluar në mënyrë të tillë, që të përcaktojnë sa më saktë dhe në mënyrë sa më të plotë, objektin e prokurimit dhe të krijojnë kushte për një procedurë të paanshme e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve.

Kërkesat dhe specifikimet teknike, mundësisht sa më të përshtatshme me kërkesat kombëtare, duhet të mbështeten në standardet ndërkombëtare ose në standardet që përdoren gjerësisht në tregun ndërkombëtar. Kjo për të realizuar prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve cilësore, të çertifikuara, serioze dhe të një teknologjie bashkëkohore që do t'i shërbejnë me sa më efektivitet Bankës së Shqipërisë.

Në përgjithësi, nuk duhet të ketë asnjë kërkesë ose referencë për karakteristika teknike të markës ose emrit, të patentës, të vizatimit a të tipit, të origjinës së prodhuesit ose të dhënësit të shërbimit.

Komisioni i Prokurimit sipas objektit konkret të prokurimit, duke gjykuar dhe argumentuar vetë rëndësinë, natyrën e punës, kushtet teknike apo specifike tepër të veçanta të mallit të kërkuar apo ekzistencën e një strategjie apo politike të miratuar nga Banka e Shqipërisë, dhe mbështetur sipas rastit në argumentimet e bëra në kërkesën për prokurim të departamentit apo strukturës përkatëse të Bankës së Shqipërisë, mund të përcaktojë markat e mallrave, qoftë si kategori "brand name" qoftë si markë e individualizuar, duke marrë në çdo rast miratimin me shkrim nga Kryetari i Entit Prokurues. Në prokurimin e mallrave me markë të individualizuar, komisioni synon të prokurojë direkt me prodhuesin ose sipas njoftimit të këtij të fundit, me përfaqësuesin e autorizuar të tij.

Në raste të veçanta për hartimin e specifikimeve teknike mund të merren edhe specialistë të tjerë jashtë Bankës së Shqipërisë kundrejt shpërblimit përkatës.

**Neni 37**
**Konfidencialiteti në përpunimin e dokumenteve**

Pas hapjes së ofertave, informacionet në lidhje me shqyrtimin, me sqarimin dhe me vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese janë konfidenciale dhe nuk duhet t'u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të lidhet kontrata.
Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk duhet t'i bëjë asnjë komunikim të pajustifikuar Bankës së Shqipërisë ose të përpiqet, në çfarëdolloj mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin dhe në vlerësimin e ofertave.

**Neni 38**
**Vlerësimi dhe klasifikimi i ofertave (kuotimeve) të ofertuesve**

Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave (kuotimeve) bën vlerësimin tekniko-ekonomik të tyre.
Gjatë kësaj faze nuk duhet të kërkohet, të ofrohet apo të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, duke përfshirë ndryshime në çmime.
Përjashtimisht nga paragrafi i mësipërm, komisioni duhet të korrigjojë gabimet aritmetike që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Komisioni, me pranimin e ofertuesit do të korrigjojë shumën totale të ofertës, e cila do të jetë e detyrueshme për ofertuesin. Mospranimi i korrigjimit është kusht skualifikues. Korrigjimi i gabimeve aritmetike do të bëhet si më poshtë:

(a) aty ku ka mospërputhje midis çmimit në shifra dhe në fjalë, do të merret në konsideratë çmimi në fjalë;

(b) aty ku ka mospërputhje midis çmimit për njësi dhe totalit që del nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, do të merret në konsideratë çmimi për njësi.

Komisioni i Prokurimit mund ta konsiderojë një ofertë të vlefshme edhe nëse: a) ajo përmban devijime të vogla, të cilat materialisht nuk ndryshojnë ose devijojnë kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim; b) oferta përmban gabime apo lapsuse, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e ofertës. Të gjitha devijimet e tilla do të mblidhen, sa të jetë e mundur dhe do t’u kushtohet vëmendja e duhur në vlerësimin dhe në krahasimin e ofertave ose të kuotimeve.
Komisioni i vlerëson ofertat (kuotimet) nga ana tekniko/ekonomike dhe për këtë qëllim harton një raport vlerësues. Ky raport nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në të mund të shprehen votat kundër, qëndrimet, mendimet, pretendimet dhe argumentet për to, të anëtarëve në rast se ka të tilla. Oferta ose kuotimi, duke respektuar paragrafin e mësipërm, konsiderohet e vlefshme vetëm në qoftë se ajo është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim.

Komisioni i Prokurimit i vlerëson dhe i krahason ofertat (kuotimet) e vlefshme, në përputhje me kriteret e vlerësimit (të caktuara me sistem pikësh) që përmbahen në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim, me qëllim që të përcaktojë ofertën ose kuotimin fitues.
Oferta apo kuotimi fitues do të jetë ajo që në bazë të kritereve të vlerësimit merr më shumë pikë.
Komisioni, në vendimin përkatës për vlerësimin dhe për klasifikimin e ofertave, mbështetur në pikët e marra, i rendit në klasifikim ofertat (kuotimet) dhe ofertuesit e tyre respektivë duke filluar nga oferta (kuotimi) fituese dhe duke vazhduar me rradhë me të gjitha ofertat (kuotimet) e tjera, përfshirë dhe ato që nuk janë kualifikuar teknikisht. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në të mund të shprehen votat kundër, qëndrimet, mendimet, pretendimet dhe argumentet për to të anëtarëve, në rast se ka të tilla.
Në rast se pas vlerësimit të ofertave tekniko-ekonomike, rezultojnë oferta pretendente të barabarta, oferta fituese do të përcaktohet nga shorti i hedhur ndërmjet ofertuesve që kanë paraqitur këto oferta të barabarta.
Në përfundim të kësaj faze, Kryetari i Komisionit të Prokurimit ka për detyrë të paraqesë te Kryetari i Entit Prokurues një informacion përmbledhës për të gjithë procedurën e kryer, si dhe argumentimin për përzgjedhjen e ofertës fituese.

## Neni 39
## Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehura në pikë. Kriteri bazë i vlerësimit është çmimi. Në çdo rast, kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një, kriteri i çmimit do të ketë jo më pak se 70 pikë. Pikët maksimale janë 100. Llogaritja e pikëve të ofertuesve kur për kriteret janë shprehur shifra, bëhet me formulën: $P_i = V_{min} \times P_{max} / V_i$ ku $P_i$ janë pikët e ofertës që vlerësohet; $P_{max}$ janë pikët maksimale; $V_i$ është vlera e ofertës që vlerësohet; $V_{min}$ është vlera e ofertës më të ulët.
Kriteret e vlerësimit janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit ose të ftesës për kuotim që do t’u jepen kandidatëve.
Komisioni i Prokurimit, përveç çmimit, në varësi të objektit konkret të prokurimit, mund të vendosë lloje të ndryshme kriteresh që konsiderohen të nevojshme si për shembull : shkalla e efektivitetit dhe e përshtatshmërisë me kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara, cilësia, lëvrimi, afati kohor, garancia, kushtet e pagesës etj.

## Neni 40
## Rastet e shtyrjes së procedurës së prokurimit

Komisioni i Prokurimit shtyn procedurën dhe cakton një datë tjetër, në rastet kur:

a) nuk plotësohet *quorumi* i nevojshëm i anëtarëve të komisionit. Data e re do të jetë jo më pak se 5 ditë pas datës së planifikuar për hapjen e ofertave;

b) komisioni gjykon që përgatitja e ofertave ose e kuotimeve, mbas sqarimeve për paqartësitë e dala gjatë hartimit të tyre, kërkon shtyrjen e datës së pranimit të tyre;

c) është vendosur modifikimi i dokumenteve të tenderit dhe një veprim i tillë cënon përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave në datën e caktuar.

d) mungon Kryetari i Komisionit dhe është i pamundur zëvendësimi i tij;

Vendimi për shtyrjen e procedurës së prokurimit për shkaqet e mësipërme duhet të shoqërohet me procesverbalin përkatës. Për rastin e parashikuar në pikën (a) të këtij neni, vendimi merret nga anëtarët e pranishëm të komisionit, të cilët nënshkruajnë dhe procesverbalin përkatës. Për këtë shtyrje të datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të njoftohen të gjithë kandidatët, të cilët kanë tërhequr dokumentet apo u është dërguar ftesa për kuotim, dhe të dokumentohet ky njoftim.
Për rastin e parashikuar në shkronjën “d” anëtari më i vjetër në moshë do të mbledhë dhe kryesojë mbledhjen e Komisionit të Prokurimit për shtyrjen e procedurës dhe caktimin e një date të re, e cila do të jetë jo më pak se 5 ditë pas datës së planifikuar për hapjen e ofertave.

**Neni 41**
**Rastet e anulimit të procedurave të prokurimit dhe përsëritja e tyre**

1. Procedura e prokurimit anulohet dhe përsëritet, në rastet kur :

a) ka mungesë konkurrence midis kandidatëve kur paraqitet vetëm një ofertues ose nuk paraqitet asnjë i tillë;

b) të gjithë ofertuesit nuk kalojnë fazën e kualifikimit ose e kalon vetëm njëri prej tyre;

c) asnjë kuotim ose ofertë e sjellë nuk plotëson kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara nga Banka e Shqipërisë ose i plotëson vetëm njëra prej tyre;

ç) të gjitha ofertat ose kuotimet janë mbi fondin limit të përcaktuar në urdhrin përkatës të prokurimit ose është brenda fondit limit vetëm njëra prej tyre;

d) vendoset nga Guvernatori në përputhje me nenin 56 të kësaj rregulloreje;

dh) vendoset nga Kryetari i Entit Prokurues deri para shpalljes së ofertuesit fitues për shkak të të metave të konstatuara;

e) vërtetohen rrethanat e parashikuara në nenin 53.

2. Kur procedura e prokurimit anulohet, data e hapjes ose e mbërritjes së ofertave ose të kuotimeve, caktohet në respektim të afateve përkatëse të njoftimit të përcaktuara në këtë rregullore për procedurat e prokurimit.

3. Kur edhe pas përsëritjes si më sipër të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit rikonstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të anulimit, ai bën sugjerimin dhe argumentimin përkatës për Kryetarin e Entit Prokurues. Në këtë rast Kryetari i

Entit Prokurues vendos për: a) përsëritjen ose jo të procedurës së prokurimit; b) anulimin e kësaj procedure dhe fillimin e një procedure tjetër me një urdhër të ri prokurimi; c) ndryshimin e formës së procedurës së prokurimit.

4. Në të gjitha rastet e anulimit, komisioni ka për detyrë të njoftojë kandidatët për këtë anulim, por nuk është i detyruar të japë shkaqet e këtij anulimi.

**Neni 42**
**Pezullimi i procedurës së prokurimit**

Procedura e prokurimit pezullohet:

a) nga Guvernatori në rastin e paraqitjes së një ankese nga ndonjëri prej kandidatëve ose ofertuesve, në përputhje me nenin 56 të kësaj rregulloreje;
b) nga Kryetari i Entit Prokurues në përputhje me nenin 43 të kësaj rregulloreje;
c) nga juristi në bazë të nenit 51 të kësaj rregulloreje.

**Neni 43**
**Rivlerësimi**

Në përputhje me nenin 56 të kësaj rregulloreje, Guvernatori kthen për rivlerësim procedurën e prokurimit.
Në rast se, deri në shpalljen e ofertuesit fitues, Kryetari i Entit Prokurues konstaton parregullsi, të meta, mangësi ose shkelje në procedurën e prokurimit, ai e pezullon këtë procedurë dhe ia kthen Komisionit të Prokurimit për rivlerësim.

**Neni 44**
**Nënsipërmarrja**

Kur kandidati do të realizojë një pjesë të objektit të prokurimit me nënsipërmarrje, kjo mund të pranohet nga Komisioni i Prokurimit me kusht që të jetë lidhur një kontratë e noteruar (përpara datës së hapjes ose pranimit të ofertave ose kuotimeve) ndërmjet kandidatit dhe nënsipërmarrësit, ku të jetë parashikuar ajo pjesë e objektit të prokurimit që do të realizohet nga nënsipërmarrësi.
Nënsipërmarrësi duhet të kualifikohet në përputhje me nenin 35 dhe me dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim.

## KREU VIII
## REALIZIMI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT

**Neni 45**
**Kërkesat për prokurim**

Enti prokurues për ndërtime, afati kohor i realizimit të të cilave kërkon vazhdimin e punimeve dhe në vitin/vitet pasardhës kalendarikë, prokuron fondet dhe mbikëqyrjen e tyre sipas vlerës së plotë të këtyre objekteve.
Enti prokurues për shërbime që kërkohen të shtrihen në vitin/vitet kalendarik/e pasardhës, prokuron sipas vlerës së plotë të objektit.
Në përputhje me fondet e planifikuara në buxhetin e Bankës së Shqipërisë të vitit ushtrimor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, çdo departament i Bankës së Shqipërisë dhe strukturë tjetër e saj, paraqet kërkesën e tij pranë Departamentit të Administrimit ku do të përfshihen:

a) Kërkesat e qarta dhe të plota lidhur me objektin e prokurimit që kërkohet të realizohet, të shprehura edhe nga ana sasiore dhe të shoqëruara me argumentimin përkatës nga departamenti kërkues.

b) Kërkesat dhe/ose specifikimet teknike në përputhje me nenin 36 të kësaj rregulloreje, të hartuara me përgjegjësi në bazë të nevojave të tyre ose të strukturave të tjera.

c) Kohën brenda të cilës është i nevojshëm përfundimi i prokurimit për departamentin që bën kërkesën.

ç) Fondin e nevojshëm të planifikuar në zërat e buxhetit të vitit ushtrimor për objektin e prokurimit.

d) Listën e punonjësve të departamentit ose të strukturës, prej të cilës do të mund të zgjidhen anëtarët përkatës të komisionit.

dh) Miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për realizimin e objektit të prokurimit nëpërmjet kontratave me kohëzgjatje më shumë se një vit kalendarik.

e) Kohëzgjatjen maksimale për kontratat me afat më të gjatë se një vit kalendarik.

## Neni 46
## Nxjerrja e urdhrit të prokurimit

Pas marrjes së kërkesave për prokurim, Departamenti i Administrimit përgatit dhe harton urdhrin e prokurimit, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Entit Prokurues.
Në urdhrin e prokurimit do të përfshihen:

a) objekti i prokurimit (kur është e mundur me sasitë dhe me afatet kohore përkatëse);
b) fondi limit i vënë në dispozicion, i shprehur në lekë për procedurat kombëtare dhe/ose në valutë për procedurat ndërkombëtare dhe për ato të kombinuara;
c) procedura e prokurimit dhe lloji i saj (kombëtare, ndërkombëtare ose e kombinuar) dhe në rastin e prokurimit të drejtpërdrejtë, emri i kandidatit;
ç) anëtarët e Komisionit të Prokurimit;
d) mënyra që do të ndiqet në hapjen dhe në shqyrtimin e ofertave (në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje), për procedurat tender i hapur dhe i kufizuar;

dh) kohëzgjatja maksimale për kontratat me afat më të gjatë se një vit kalendarik.

## Neni 47
## Njoftimi i Komisionit të Prokurimit

Pas nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, Kryetari i Komisionit të Prokurimit njofton komisionin duke respektuar dispozitat e mëposhtme:

Lajmërimi i anëtarëve për mbledhjen e parë të komisionit bëhet nga Kryetari i Komisionit të Prokurimit, nëpërmjet njoftimit nominativ me shkrim, të paktën dy ditë përpara nga data e mbledhjes së parë të komisionit.
Në njoftimin e mësipërm përcaktohet data dhe ora e saktë e mbledhjes. Akti i thirrjes duhet të jetë i shoqëruar me materialet dhe me relacionet përkatëse shoqëruese, të përgatitura nga Departamenti i Administrimit (Sektori i Prokurimit), që do të shqyrtohen në mbledhjen e komisionit. Gjatë përgatitjes së këtyre dokumenteve, Sektori i Prokurimit bashkëpunon ngushtë me specialistët e departamentit përkatës, që ka bërë kërkesën për kryerjen e prokurimit.

Anëtari që nuk është lajmëruar si më lart ose që për shkaqe të arsyeshme nuk ka marrë dijeni në kohë për këtë lajmërim, ka të drejtë të refuzojë pjesëmarrjen në mbledhjen e Komisionit të Prokurimit. Pavarësisht nga mosrespektimi i dispozitave të mësipërme të njoftimit, Komisioni i Prokurimit i zhvillon mbledhjet e tij në rast se plotësohet *quorumi* i nevojshëm, në përputhje me nenin 50 të kësaj rregulloreje dhe anëtarët, e pranishëm në mbledhje, shprehen dakord për një gjë të tillë.
Anëtari i Komisionit të Prokurimit, është i detyruar të vërë në dijeni drejtorin e tij përkatës ose personin që e zëvendëson, për marrjen e kësaj detyre, për datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjeve të komisionit. Drejtori ose zëvendësuesi i tij, organizon punën dhe merr të gjitha masat e mundshme për të mos e ngarkuar atë me detyra të tjera, që do të pengonin pjesëmarrjen në mbledhjet e komisionit.
Kur anëtari është në pamundësi për të marrë pjesë në mbledhjen e prokurimit, me arsye objektive pune, atëherë mungesa e tij në mbledhje justifikohet nga drejtuesi i departamentit ose zëvendësi i tij.

## Neni 48
## Përbërja e Komisionit të Prokurimit

Komisioni i Prokurimit, si rregull, përbëhet nga 5 anëtarë, përfshirë dhe Kryetarin e Komisionit të Prokurimit. Kryetari i Komisionit të Prokurimit emërohet nga Guvernatori, me propozim të Kryetarit të Entit Prokurues, për një periudhë deri në 2 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Funksioni i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër, përfshirë atë të Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimit në Bankën e Shqipërisë, dhe paga e tij barazohet me pagën e zëvendësdrejtorit të departamentit. Anëtarët e tjerë të komisionit me të drejtë vote

janë të ndryshueshëm për çdo rast konkret të kryerjes së një procedure prokurimi, dhe caktohen, për çdo rast konkret prokurimi, nga Kryetari i Entit Prokurues në urdhrin përkatës të prokurimit. Si rregull i përgjithshëm, këta anëtarë duhet të jenë një ekonomist dhe tre specialistë të fushës konkrete për të cilën zhvillohet procedura e prokurimit.

Në rastet e tenderave të rëndësishëm ose të një natyre specifike, kur propozohet nga Kryetari i Komisionit të Prokurimit, në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike dhe/ose të vlerësimit të ofertave, në komision shtohen me "Urdhër" me shkrim të Kryetarit të Entit Prokurues, jo më pak se dy specialistë të kualifikuar të tjerë, brenda ose jashtë Bankës së Shqipërisë, në përputhje me specifikën e objektit të prokurimit.

Për procedurat e prokurimeve që janë në proces, si dhe për procedurat e reja të prokurimit, në mungesë të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit, Guvernatori cakton me shkrim një person zëvendësues, i cili gjatë mungesës së kryetarit, do të ushtrojë kompetencat dhe detyrat që kjo rregullore përcakton për kryetarin e komisionit.

### Neni 49
### Kompetencat dhe detyrat kryesore të komisionit të prokurimit

Komisioni i Prokurimit ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe ka këto kompetenca dhe detyra kryesore:

a) Përcakton dhe vendos mbi
- ndarjen në lote të objektit të prokurimit kur çmohet e nevojshme;
- dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim që do t’u shpërndahen kandidatëve;
- specifikimet teknike;
- kriteret e vlerësimit;
- kualifikimin e kandidatëve;
- vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave ose të kuotimeve dhe përzgjedhjen e asaj fituese.

b) Në bashkëpunim me Sektorin e Prokurimit, përzgjedh nga publikime të ndryshme, propozime të ardhura nga Departamentet me paraqitjen e kërkesës si dhe të dhënat e mbledhura nga studimi i tregut, kandidatët të cilët do të ftohen për të marrë pjesë në “Tenderin e kufizuar” ose në “Ftesën për kuotim”.

c) Merr pjesë dhe ka autoritet në hapjen, në shqyrtimin dhe në vlerësimin e ofertave të dorëzuara nga ofertuesit, në përputhje me dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim për procedurën konkrete të prokurimit.

ç) Shqyrton dhe vendos për të gjithë dokumentacionin e sjellë nga ofertuesit.

d) Detyrohet të ruajë fshehtësinë e informacionit lidhur me shqyrtimin, me sqarimin, me vlerësimin dhe me zgjedhjen e fituesit deri sa të shpallet lidhja e kontratës.

Kryetari i Komisionit të Prokurimit organizon mbarëvajtjen e punës së komisionit gjatë procedurës së prokurimit, deri në klasifikimin përfundimtar të ofertave.

Anëtarët e caktuar për të marrë pjesë në Komisionin e Prokurimit shpërblehen me shumën prej 1000 lekësh. Ky shpërblim do të jepet mbas shpalljes së ofertuesit

fitues. E drejta për shpërblim humbet për mospjesëmarrje në 2 (dy) mbledhje të komisionit.

**Neni 50**
**Quorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja në mbledhjet e komisionit**

Mbledhja e Komisionit të Prokurimit kryesohet nga Kryetari i Komisionit të Prokurimit dhe në mungesë të tij nga zëvendësuesi i tij. *Quorumi* i nevojshëm për vlefshmërinë e zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit të Prokurimit është jo më pak se 4 anëtarë kur komisioni përbëhet prej 5 anëtarësh, dhe jo më pak se 5 anëtarë kur komisioni përbëhet prej 7 anëtarësh. Mungesa e anëtarëve në mbledhjet e komisionit evidentohet në procesverbal dhe, në rast se dihet, edhe arsyeja e kësaj mungese. Anëtari që ka munguar është i detyruar të njihet me procesverbalin dhe me materialet e mbledhjes së mëparshme si dhe të japë sipas rastit, mendimin dhe/ose votën e tij.
Secili nga anëtarët e komisionit ka të drejtën e një vote. Mendimi, argumentet dhe vota e secilit anëtar për çdo çështje mbi dhe/ose lidhur me prokurimin regjistrohen në procesverbalin e mbledhjeve të komisionit. Komisioni merr vendim me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit ose në mungesë të tij e kryesuesit të mbledhjes është përcaktuese. Nuk lejohet abstenimi në votim.

**Neni 51**
**Sektori i Prokurimeve**

Sektori i Prokurimeve për efekt të kësaj rregulloreje ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:
- Rishikon fondin limit të përcaktuar në buxhet dhe të paraqitur nga departamenti kërkues sipas nenit 45/ç të kësaj rregulloreje, duke u mbështetur në studimin e tregut, në përvojën e mëparshme të Entit Prokurues si dhe në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT dhe institucione të tjera shtetërore përkatëse kur ky informacion është i disponueshëm. Rezulati i nxjerrë nga studimi i tregut duhet të bazohet në jo më pak se dy oferta.
- Në rastet e prokurimit të drejtpërdrejtë studimi i tregut realizohet vetëm me ofertën e kandidatit të ftuar.
- Në rast përsëritje të procedurës së prokurimit, ofertat mbi studimin e tregut mund të përdoren si bazë në studimin pasardhës, kur përsëritja e procedurave të prokurimit realizohet brenda tre muajve nga data e studimit të parë të tregut.
- Në rastet kur pas procedurës së rishikimit të fondit siç përcaktohet më lart, fondi i nevojshëm për objektin konkret të prokurimit rezulton më i ulët se fondi i paraqitur nga departamenti kërkues, për realizimin e këtij objekti do të përdoret fondi i rishikuar.

- Vë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit materialet përkatëse paraprake të hartuara sipas dokumenteve standarde të prokurimit, në përputhje me procedurën e prokurimit dhe me objektin që do të prokurohet.
- Përgatit dhe përpilon dokumentet e tenderit, të ftesës për kuotim ose të prokurimit të drejtpërdrejtë sipas vendimeve të komisionit dhe siguron nënshkrimin e tyre nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- Ka përgjegjësi për shpalljen dhe për dërgimin e njoftimit për tender, për shpërndarjen e ftesave për ofertë, për dërgimin për botim në afat të njoftimeve përkatëse për zhvillimin e tenderave, për sigurimin e materialeve, për plotësimin e dokumenteve të tenderit (si skema grafike, detyra projektimi etj.), për dorëzimin e këtyre dokumenteve kandidatëve që dëshirojnë të marrin pjesë në tender, për zbatimin e afateve të njoftimit të parashikuara në këtë rregullore për procedurat e prokurimit, për llogaritjen e çmimit me të cilin do t'u shiten dokumentet e tenderit kandidatëve (duke u bazuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje).
- Gjatë përgatitjes së ofertave nga kandidatët, ka për detyrë sqarimin e kandidatëve për çdo paqartësi, që mund të kenë gjatë hartimit të ofertave në lidhje me dokumentacionin e marrë nga Banka e Shqipërisë, deri në çastin e hapjes së ofertave.
- Mban dhe nënshkruan të gjitha procesverbalet e mbledhjeve dhe zbardh vendimin e Komisionit të Prokurimit, që, detyrimisht, duhet të jenë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Prokurimit të pranishëm në mbledhje. Mbledh dhe organizon në një dosje të gjithë dokumentacionin e prokurimit (që nga kërkesat për prokurim, urdhrin e prokurimit, njoftimet, vendimet etj., deri në shpalljen e fituesit) dhe dorëzon dosjen në Arkivin e Bankës së Shqipërisë, në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 53 të kësaj rregulloreje.
- Bashkëpunon me departamentet dhe me strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë.
- Asiston të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Komisioni i Prokurimit, por është pa të drejtë vote.

Procedurat e prokurimit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje mbikëqyren nga juristi i angazhuar në procedurën e prokurimit, i cili konfirmon rregullsinë e procedurës në procesverbalet e mbledhjeve dhe në vendimin e Komisionit të Prokurimit.

Juristi ka të drejtën e pezullimit të mëtejshëm të procedurave të prokurimit, në çdo faze që konstaton shkelje të tyre dhe informon menjëherë me shkrim Kryetarin e Entit Prokurues, vendimi i të cilit mbi këtë pezullim është i formës së prerë. Vendimi nga ana e Kryetarit të Entit Prokurues merret brenda 5(pesë) ditëve nga momenti i pezullimit të procedurës nga ana e juristit.

### Neni 52
### Konflikti i interesave dhe deklarimi i tij

Asnjë nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit nuk duhet të ketë marrëdhënie biznesi apo interesash privatë me kandidatët ose me ofertuesit apo lidhje gjaku deri në shkallën e dytë me aksionerët, me ortakët apo me administratorët e tyre, të cilësuar

shprehimisht në dokumentet e tenderit. Anëtarët e komisionit duhet të deklarojnë ekzistencën ose jo të konfliktit të interesave. Për këtë qëllim, bëhet deklaratë me shkrim nga secili anëtar, si vijon:

a- në tenderin e hapur, deklarata bëhet në momentin e hapjes së ofertave në Bankën e Shqipërisë dhe në shqyrtimin e dokumenteve për kualifikim;
b- në tenderin e kufizuar dhe në ftesën për kuotim, deklarata bëhet si në momentin e përcaktimit të kandidatëve nga komisioni, ashtu edhe në momentin e hapjes së ofertave dhe në shqyrtimin e dokumenteve për kualifikim.

Në rastet kur ndonjë nga anëtarët deklaron se ekzistojnë këto lidhje, pasi ai jep argumentimet dhe shpjegimet përkatëse, zëvendësohet me një tjetër, nga Kryetari i Entit Prokurues pas relatimit me shkrim të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit.

## Neni 53
## Shpallja e ofertës fituese dhe njoftimi i ofertuesit fitues

Kryetari i Komisionit të Prokurimit, në zbatim të nenit 38 të kësaj rregulloreje, i paraqet Kryetarit të Entit Prokurues informacionin përmbledhës. Ky informacion shoqërohet me raportin përmbledhës si dhe me vendimin e komisionit për klasifikimin e ofertave dhe për përzgjedhjen e ofertës fituese. Kryetari i Entit Prokurues në bazë të dokumentacionit të lartpërmendur, gjykon nëse është e nevojshme të kërkohet për shqyrtim i gjithë dokumentacioni i procedurës së prokurimit.

Nëse gjykohet i rregullt, brenda afatit prej 2 javësh nga marrja e vendimit të komisionit, Kryetari i Entit Prokurues bën shpalljen e ofertës fituese duke nënshkruar njoftimin e ofertuesit fitues, por gjithnjë brenda periudhës minimale të vlefshmërisë së ofertës apo të kuotimit, e përcaktuar në dokumentet e tenderit apo të ftesës për kuotim. Në rast të kundërt, procedura e prokurimit anulohet.

Sektori i Prokurimit dërgon njoftimin për ofertuesin fitues, si dhe u dërgon të gjithë ofertuesve të tjerë jo të suksesshëm, klasifikimin e ofertave me pikët përkatëse të marra nga ofertuesit, në bazë të kritereve të vlerësimit, të përcaktuara në dokumentet e tenderit apo të ftesës për kuotim.

Bazuar në shpalljen e ofertës fituese dhe në njoftimin për ofertuesin fitues, Departamenti i Administrimit negocion për lidhjen e kontratës. Kontrata për procedurat e prokurimit tender ose ftesë për kuotim lidhet vetëm pasi të ketë kaluar afati 10-ditor, i parashikuar në nenin 55 për ankimin administrativ.

Nëse ofertuesi fitues, brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentet e tenderit, nuk pranon të lidhë kontratë, enti prokurues bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe nëse diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vendin e parë dhe asaj të klasifikuar në vendin e dytë, do të jetë jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, atëherë do të shpallet si fitues pjesëmarrësi i renditur i dyti në klasifikim.

Në raste urgjente, kur diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vendin e parë dhe asaj të klasifikuar në vendin e dytë, do të jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, atëherë Departamenti i Administrimit, me miratim të Kryetarit të Entit

Prokurues, paraqet në Këshillin Mbikëqyrës projektvendimin për lidhjen e kontratës me ofertuesin i klasifikuar i dyti.
Në rast se edhe ofertuesi i klasifikuar i dyti nuk pranon të lidhë kontratë atëherë procedura anulohet.
Me nënshkrimin e kontratës, dosja e plotë e dokumenteve të prokurimit dhe një kopje e kontratës depozitohen në Arshivën e Bankës së Shqipërisë, ku ruhen dhe administrohen sipas mënyrës dhe kohës që parashikohet në ligjin për arkivat dhe në ligjin për informimin publik, si dhe në rregulloret përkatëse të Bankës së Shqipërisë. Në të nuk lejohet të bëhen korrigjime dhe mund t'i jepet për shqyrtim vetëm personave të autorizuar.

### Neni 54
### Përfaqësuesit në kontratën që lidhet

Në përputhje me shkallën e nënshkrimeve të autorizuara në Bankën e Shqipërisë, përfaqësuesit në kontratën që do të nënshkruhet midis Bankës së Shqipërisë dhe ofertuesit fitues do të kategorizohen si vijon:

⇒ për kontrata mbi kufirin prej 4.200.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) Kryetari i Entit Prokurues;
⇒ për kontrata deri në 4.200.000 lekë (ose kundërvleftën në monedha të tjera të huaja) Drejtori i Departamentit të Administrimit.

Në qoftë se kursi mesatar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë do të ndryshojë tej kufirit +/- 10 për qind, kufiri monetar do të ndryshojë në raport me kursin e këmbimit.
Në mungesë të Kryetarit të Entit Prokurues, Guvernatori autorizon një person tjetër për nënshkrimin e kontratës.

## KREU IX
## ANKIMI ADMINISTRATIV

### Neni 55
### E drejta për ankim

Çdo kandidat ose ofertues është i lirë të kërkojë shqyrtimin administrativ për veprime ose mosveprime, që konsiderohen prej tij si shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje.
Ankimi i paraqitet me shkrim Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Guvernatori shqyrton ankimin vetëm kur ai paraqitet brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së ofertës fituese ose e rrethanave që janë objekt ankimi.

Ankesa nuk mund të merret parasysh pas hyrjes në fuqi të kontratës që është nënshkruar midis palëve.

Përjashtimisht nuk lejohet ankim :

a) për caktimin e një procedure prokurimi në bazë të kreut II;
b) për vendimin e marrë në bazë të nenit 32 për të refuzuar të gjitha ofertat ose kuotimet;
c) pas lidhjes së kontratës me ofertuesin fitues.

### Neni 56
### Shqyrtimi i ankesës nga Guvernatori

Guvernatori, me marrjen e ankesës pezullon procedurën e prokurimit dhe pas shqyrtimit të ankesës duhet të bëjë të njohur me shkrim vendimin, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në vendim jepen arsyet dhe në rast se ankesa është quajtur e vlefshme tregohen masat korrigjuese, që sipas rastit përmbajnë: kthimin e procedurës për rivlerësim ose anulimin e procedurës së prokurimit. Vendimi i Guvernatorit është përfundimtar.

## KREU X
## KUSHTE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT

### Neni 57
### Për mallrat

Kur prokurohen mallra, në rast se kërkohet në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim ose në prokurimin e drejtpërdrejtë, si rregull, kontrata e përgatitur për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë për lëvrimin e mallrave garanton pagesë të plotë për mallrat e kontraktuar, pas lëvrimit dhe testimit të tyre. Sipas gjykimit të komisionit ose të Departamentit të Administrimit dhe sipas objektit konkret të prokurimit, në kontratë, mund të parashikohen edhe pagesa pjesore, për mallin e lëvruar (e kontrolluar) në parti ose të lëvruar dhe të instaluar/montuar me faza.

Në rastet kur Departamenti i Administrimit ose Komisioni i Prokurimit e gjykon të arsyeshme, mund të parashikohet pagesa me anë të parapagimit (paradhënie) e cila mund të ndryshojë në varësi të çmimit të kontratës që do të lidhet. Në këtë rast, ofertuesi me të cilin do të nënshkruhet kontrata, duhet të bllokojë për llogari të Bankës së Shqipërisë “Sigurimin e kontratës” (neni 30 i kësaj rregulloreje), i cili duhet të jetë me një shumë të barabartë ose më të madhe (sipas rastit konkret) se shuma e parapagimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë. Përjashtimisht, sipas rastit konkret të prokurimit, mund të lejohet parapagimi mbi kufirin e përcaktuar si më sipër, vetëm me propozim të Komisionit të Prokurimit ose të Departamentit të Administrimit dhe me miratimin me shkrim të Kryetarit të Entit Prokurues.

Mallrat të cilët, për vetë natyrën dhe specifikat e tyre, kërkojnë edhe shërbim mirëmbajtjeje, do të prokurohen nga komisioni së bashku me këtë shërbim, i cili gjatë periudhës së garancisë së mallit duhet të mbulohet nga kjo garanci dhe duhet të përfshihet në vleftën e ofertës së dhënë.

Në rastet e kontraktimit me ofertues të huaj, duhet t'i jepet përparësi mënyrës së pagesës me L/C (letërkredi) të pakthyeshme.
Mënyra dhe afatet e lëvrimit të mallit do të jenë sipas kritereve të vendosura nga Komisioni i Prokurimit në dokumentet e tenderit ose të ftesës për ofertë apo të prokurimit të drejtpërdrejtë.

**Neni 58**
**Për ndërtimet**

Për sipërmarrjet e ndërtimeve, projekti duhet të jetë i përfunduar në fazën e projektzbatimit të hollësishëm, në mënyrë që zërat dhe vëllimet e punës të jenë të përcaktuara mirë në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim.
Sipërmarrjet mund të prokurohen "me punime në matje dhe me çmime të pandryshueshme" atëherë kur vëllimet e punës të dhëna në projekt mund të ndryshojnë gjatë zbatimit. Në këtë rast, fituesi i tenderit është i detyruar të mbajë të pandryshueshme çmimet- njësi, të dhëna në ofertën e paraqitur.
Sipërmarrjet e ndërtimit mund të prokurohen edhe me "çelësa në dorë", atëherë kur volumet e punës të dhëna në projekt janë orientuese dhe shoqëritë konkuruese duhet të bëjnë një studim të hollësishëm të projektit, duke mos qenë të detyruara t'u përmbahen këtyre volumeve. Në këtë rast, fituesi i tenderit ka përgjegjësinë e dorëzimit të objektit pa pretenduar asnjë shtesë fondi mbi vlerën e ofertës së paraqitur në tender, me të cilën është shpallur fitues, duke iu përgjigjur, brenda kësaj vlere, të gjitha detyrimeve fiskale sipas ligjeve në fuqi.
Volumet e punës në sipërmarrjet e ndërtimit duhet të jenë të plota me të gjitha zërat dhe përqindjet, që Banka e Shqipërisë gjykon se duhen fiksuar (si për shembull, fondi rezervë, minimumi i fitimit të planifikuar, minimumi i shpenzimeve plotësuese, përqindja e TVSh-së etj.) për rastet kur kontratat parashikohen me punime në matje, me çmime të pandryshueshme.
Specifikimet teknike në sipërmarrjet e ndërtimit duhet të shprehin qartë kërkesat e Bankës së Shqipërisë në lidhje me cilësinë e çdo punimi, me materialet që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që ka Banka e Shqipërisë, përveç atyre të parashikuara në projektzbatimin e në kushtet teknike.

Përveç kërkesave për kualifikim, të parashikuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, për prokurimin e ndërtimeve do të kërkohen prej kandidatëve edhe të dhëna të tjera lidhur me :

- kualifikimet dhe licencat e personelit që do të merret direkt me zbatimin e objektit, domethënë të stafit drejtues përgjegjës për realizimin e objektit;
- numrin e llojin e makinerive dhe të pajisjeve, domethënë kapacitetin teknik të domosdoshëm për zbatimin e objektit;
- vlerën minimale të objekteve të ngjashme, të ndërtuara nga sipërmarrësi (të dokumentuara me çertifikatë nga investitori), në mënyrë që ky i fundit të fitojë besimin e Bankës së Shqipërisë nëse është i aftë apo jo të kryejë punimet që kërkohen.

Në qoftë se sipërmarrësi plotëson këto kërkesa për kualifikim në masën e dhënë në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim si dhe kërkesat teknike të Bankës së Shqipërisë, kualifikohet dhe pastaj vlerësohet për çmimin (dhe afatin, në qoftë se ky është parashikuar si kriter vlerësimi në dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim) që paraqet në ofertën ekonomike, ku si çmim do të merret vlera e plotë e preventivit.

Rradha e punimeve dhe përfundimi i fazave të ndryshme ose i nënobjekteve, duhet dhënë në qoftë se Banka e Shqipërisë e gjykon të nevojshme që punimet duhen kryer detyrimisht sipas një rradhe të caktuar.

Për elemente të veçanta të procedurave të prokurimit të ndërtimeve, të cilat nuk përfshihen në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do t'i referohet dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë.

**Neni 59**
**Për projektimet**

Për fillimin e procedurës së shërbimeve të projektimeve, detyra e projektimit e përgatitur nga Banka e Shqipërisë (Departamenti i Administrimit) duhet të jetë e plotë dhe e qartë, në mënyrë që t'u japë mundësi të barabartë të gjithë konkurruesve. Në të detyrimisht duhet të përcaktohet fondi i parashikuar për ndërtimin e objektit.

Në specifikimet teknike duhet të shprehen saktë të gjitha kërkesat që Banka e Shqipërisë ka për projektimin e objektit, ana funksionale e teknologjike e veprës, rifiniturat dhe materialet që duhen përdorur etj.

Përveç kërkesave për kualifikim, të parashikuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, për prokurimin e projektimeve do të kërkohen prej kandidatëve edhe të dhëna të tjera lidhur me :

- kualifikimet dhe licencat e personave që do të merren direkt me projektimin e objektit, me drejtimin e punimeve ose me konsulencën, domethënë *curriculum vitae* të secilit person ;
- projektet e ngjashme, gjithnjë të vërtetuara me çertifikata nga punëdhënësit (në qoftë se janë projektuar para vitit 1992, vlera e plotë e tyre do të llogaritet me koeficientin e konvertimit).
- Përveç kërkesave për kualifikimin, të parashikuara sa më sipër dhe atyre të përgjithshme të parashikuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, kandidatëve do t'u kërkohet, sipas gjykimit të Komisionit të Prokurimit, skicëidea ose projektidea dhe preventivi paraprak, me çmime të njëjta për të gjithë konkurruesit (duke dhënë dhe udhëzimet përkatëse se si do të merren këto çmime) ose pa çmime kur kjo nuk është e mundur.

Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit për shërbimet e projektimeve, duhet të kihet parasysh që të shënohet në dokumentet e tenderit, që të gjithë kandidatët duhet të përjashtohen nga prokurimet e mallrave apo të ndërtimeve që kanë lidhje me projektin në fjalë. Në dokumentet e tenderit për shërbimet e projektimeve, në urdhrin e prokurimit, fondi i vënë në dispozicion është vlera e pagesës së projektit dhe jo fondi i plotë i objektit. Ky i fundit do të jepet në detyrën e projektimit.

Për projektimet, mënyra e përzgjedhjes do të jetë me vlerësimin me jo më pak se 75 pikë për ofertën teknike, domethënë cilësinë e projektit; rreth 15 pikë për ofertën ekonomike, domethënë vlerën e preventivit paraprak dhe rreth 10 pikë për çmimin e vetë projektit.
Preventivi i projektzbatimit, mbas reflektimit të të gjitha vërejtjeve të komisionit, nuk mund të tejkalojë vlerën e preventivit paraprak të hartuar në bazë të projektidesë dhe të paraqitur për konkurim; në rast të kundërt, projektuesit i mbahet garancia bankare e sigurimit të kontratës.
Një projektues nuk mund të paraqitet njëkohësisht në stafin e dy shoqërive projektuese të ndryshme, që marrin pjesë në tender për të njëjtin objekt.
Për rastet e projekteve me vlera të vogla, projektidea dhe preventivi paraprak realizohen nga inxhinierët e Bankës së Shqipërisë, pastaj kalohet në fazën tjetër të tenderit për përzgjedhjen e firmës që do të realizojë projektzbatimin.
Për elemente të veçanta të procedurave të prokurimit të projektimeve të cilat nuk përfshihen në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do t'i referohet dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë.

**Neni 60**
**Për shërbimet**

Në rastin kur kërkohet kryerja e shërbimeve të caktuara, lloji i shërbimit duhet të jetë i shprehur saktë, me të gjitha kërkesat specifike të Bankës së Shqipërisë në cilësi dhe në afat.
Kur prokurohen shërbime, në rast se kërkohet në dokumentet e tenderit, të ftesës për kuotim ose prokurimit të drejtpërdrejtë kontrata e përgatitur për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e shërbimeve garanton pagesë të plotë për shërbimin e kryer. Sipas gjykimit të komisionit ose të Departamentit të Administrimit dhe sipas objektit konkret të prokurimit, në kontratë mund të parashikohen edhe pagesa pjesore për shërbim pjesor të kryer.
Në rastet kur komisioni ose Departamenti i Administrimit e gjykon të arsyeshme, i propozon Kryetarit të Entit Prokurues të parashikohet pagesë me anë të parapagimit (paradhënie), e cila mund të ndryshojë në varësi të çmimit të kontratës që do të lidhet. Në këtë rast, ofertuesi me të cilin do të nënshkruhet kontrata, bllokon për llogari të Bankës së Shqipërisë "Sigurimin e kontratës" (neni 30 i kësaj rregulloreje), i cili duhet të jetë me një shumë të barabartë ose më të madhe (sipas rastit konkret) se shuma e parapagimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë. Përjashtimisht, sipas rastit konkret të prokurimit, mund të lejohet parapagimi mbi kufirin e përcaktuar si më sipër vetëm me propozim të Komisionit të Prokurimit ose të Departamentit të Administrimit dhe me miratimin me shkrim të Kryetarit të Entit Prokurues.
Sipas rastit konkret dhe gjykimit të komisionit ose të Departamentit të Administrimit, për kontratat e shërbimit, shuma e sigurimit të kontratës mund të parashikohet që të reduktohet sipas periudhave të përcaktuara të kryerjes së shërbimit.

**Neni 61**

**Për pasuritë e paluajtshme**

Për blerjen e pasurive të paluajtshme, prokurohet nëpërmjet prokurimit të drejtpërdrejtë sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm në rastet kur:

a- kërkesat e paraqitura nga departamenti/ struktura kërkuese për blerjen e pasurive të paluajshme janë tepër specifike dhe tregu nuk ofron konkurrencën e nevojshme për realizimin e procedurës në formën “Tender i Hapur Kombëtar“

b- procedura e zhvilluar është anuluar në mënyrë të përsëritur dhe vërtetohen kushtet e nenit 41/1 dhe 41/3 te kesaj rregulloreje.

Kërkesa për blerjen e pasurive të paluajtshme formulohet nga Departamenti i Administrimit, sipas kërkesave dhe/ose nevojave të strukturave të Bankës së Shqiperisë dhe paraqitet pranë Kryetarit të Entit Prokurues të Bankës së Shqiperisë. Në kërkesë argumentohet domosdoshmëria e përdorimit të kësaj procedure prokurimi dhe pasqyrohen gjithë kërkesat teknike të blerjes së objektit/ pasurisë dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në nenin 45 të kësaj rregulloreje, si dhe propozimi përkatës për ngritjen e Grupit të Shqyrtimit Paraprak të mundësive të tregut.

Pas miratimit të kërkesës nga Kryetari i Entit Prokurues dhe miratimit të Grupit të Shqyrtimit Paraprak dhe përcaktimin e kompetencave të tij ky grup fillon punën për përzgjedhjen e objektit/pasurisë, që plotëson më mirë kërkesat tekniko-ekonomike të Bankës së Shqipërisë.

Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, Grupi i Shqyrtimit Paraprak dorëzon pranë Kryetarit të Entit Prokurues relacionin e plotë për pasurinë/ objektin e përzgjedhur, ku përcaktohet dhe arsyetohet qartë plotësimi i kërkesave teknike të Bankës së Shqipërisë. Në relacion përcaktohet dhe arësyetohet dhe cmimi tavan për blerjen e objektit/ pasurisë.

Kryetari i Entit Prokurues paraqet për miratim pranë Këshillit Mbikëqyrës kërkesën për blerjen e objektit/pasurisë konkrete të përzgjedhur nga Grupi i Shqyrtimit Paraprak, me procedurën “prokurim i drejtëpërdrejtë” sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Pas miratimit të Këshillit Mbikëqyrës, Kryetari i Entit Prokurues miraton urdhërin përkatës të prokurimit, sipas nenit 46 të kësaj rregulloreje.

Për elemente të veçanta të procedurave të prokurimit të pasurive të paluajtshme, të cilat nuk përfshihen në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do t’i referohet dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë.

## KREU XI
## Dispozita të fundit

### Neni 62
### Blerjet/shërbimet me vlerë të vogël

Nga format e mësipërme të prokurimit përjashtohen blerjet/shërbimet me vlerë të vogël, për të cilat i bëhet referencë udhëzimit për blerjet/shërbimet me vlerë të vogël, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

**Neni 63**
**Lista e ofertuesve të përjashtuar**

Me propozim të Departamentit të Administrimit (Sektorit të Prokurimit), Kryetari i Entit Prokurues vendos për përjashtimin nga prokurimet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë nga 1 – 3 vjet të:

- kandidatëve që për kualifikimin e tyre sipas kërkesave të nenit 35 kanë paraqitur dokumente të rreme;
- ofertuesve që kanë paraqitur dokumentacion të rremë;
- ofertuesve të shpallur fitues që janë tërhequr nga lidhja e kontratës;
- kandidatëve/ofertuesve që paraqesin informacione të rreme ose keqdashëse;
- kontraktuesve me të cilët është zgjidhur kontrata për mosrespektim të kushteve kontraktore.

Vendimi i komunikohet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe botohet në Buletinin Zyrtar si dhe në *Website*-n e Bankës së Shqipërisë.

Nuk mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit të Bankës së Shqipërisë gjithë subjektet e përjashtuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të shpallura në buletinin përkatës, për aq kohë sa ky përjashtim është në fuqi.

**Neni 64**
**Dokumentet standarde të prokurimit**

Në mbështetje dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, Guvernatori miraton dokumentet standarde të prokurimit.

**Neni 65**
**Dispozita përfundimtare**

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 81 datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI I KESHILLIT MBIKËQYRËS**

**Ardian FULLANI**